

## **Takim rajonal i Avokatit të Popullit me Komisionet për marrëdhënie mes komuniteteve**

Më 26 qershor të vitit 2008 në Tetovë u mbajt takim rajonal i Avokatit të Popullit – zyra rajonale në Tetovë me Komisionet për marrëdhënie mes komuniteteve nga komuna e Tetovës, Gostivarit, Vrapçishtit, Jegunovcës, Bogovinjes dhe Mavrovës dhe Rostushës.

Qëllimi i takimit rajonal ishte të iniciohet bashkëpunimi mes Avokatit të Popullit dhe Komisioneve për marrëdhënie mes komuniteteve për çështje që kanë të bëjnë me bashkësitë etnike që nuk janë shumicë. Prezantim të shkurtë në takim bëri Sunçica Kostovska – Petrovska, menaxhere e projektit, duke i prezantuar qëllimet e projektit dhe aktivitetet e planifikuara.

Marina Obadiq – Zëvendës Avokati i Popullit i njoftoi të pranishmit me kompetencat e institucionit Avokat i Popullit në pjesën për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve. Gjithashtu, ajo sqaroi se me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë dhe amendamentet e Kushtetutës së 2001, kompetencat e Avokatit të Popullit zgjerohen edhe në domenin e ndjekjes së gjendjes me përfaqësimin e drejtë dhe gjendjen me mbrojtjen nga diskriminimi të pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike. Deri tani, përveç një rasti, nuk kanë pas ankesa për diskriminim. Ajo theksoi se bashkëpunimi me institucionet shtetërore nuk është në nivelin e duhur. Me përkrahjen e kryetarit të Komunës së Gostivarit një ditë në javë Zëvendës Avokatit të Popullit i është dhënë zyrë për tu takuar me palë në komunë dhe në këtë mënyrë mundësohet komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarët.

Përfaqësuesit e Komisionit e prezantuan strukturën dhe mënyrën e funksionimit të tyre, duke i theksuar përparësitë e punës së tyre në komunat ku janë arritur rezultate të dukshme, por edhe problemet në të cilat hasin (kyçjen e anëtarëve të jashtëm në përbërjet e komisioneve, baraspesha etnike dhe vazhdimësia e komisionit, buxheti i komisionit, ndërrimi i anëtarëve të komisionit, njoftimi i qytetarëve me kompetencat e komisionit). Ata shprehën dëshirë dhe gatishmëri për bashkëpunim më të madh me bashkësitë lokale dhe organizatat joqeveritare, por edhe intensifikimin e bashkëpunimit me Avokatin e Popullit. Në pjesën për debat pjesëmarrësit morën përgjigje konkrete nga Avokati i popullit për çështje që kanë të bëjnë me procedurën e dorëzimit të ankesave nga ana e komisioneve dhe roli i vetëqeverisjes lokale dhe i këshillit komunal në tërë procedurën. Në takim u prezantuan përvojat e Bashkësisë së Njësive të Vetëqeverisjes Lokale nga Natasha Vrteska, këshilltar juridik në BNJVL. Ajo theksoi se BNJVL-ja dot formon trup punues për ti shqyrtuar problemet e komisioneve për marrëdhënie mes bashkësive që të mundet të reagojnë në mënyrë adekuate.

Në takim u sollën konkludimet në vijim: opinioni të njoftohet më mirë me rolet dhe detyrat e komisioneve për marrëdhënie mes bashkësive dhe Avokatit të Popullit dhe mënyrat për shfrytëzimin e kompetencave të tyre, komisionet të punojnë në promovimin e bashkëpunimit mes bashkësive etnike, shteti tu kushton vëmendje rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe më tepër të punohet në përmirësimin/intensifikimin e bashkëpunimit mes komisioneve për marrëdhënie mes bashkësive dhe Avokatit të Popullit.

Moderator i takimit ishte Igor Tasevski nga Qendra për Iniciativa Qytetare – Prilep. Takimin e organizoi Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me organizatën joqeveritare “Vlera të përbashkëta” nga Shkupi.